

Njoftim për përqendrim me të cilin “Telekom Serbia” shoqëri aksionare, Beograd, Republika e Serbisë do të fitojë kontroll mbi KDS-NET SHPK, Vršac, Republika e Serbisë

(lënda nr. 08-137/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 18.09.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin “Telekom Serbia” shoqëri aksionare, Beograd, me seli të regjistruar në rrugën “Takovska” nr. 2, Beograd, Republika e Serbisë, synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi KDS-NET SHPK Vršac, me seli të regjistruar në rrugën Sime Gvozdenova 33, 26 300 Vršac, Republika e Serbisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

“Telekom Serbia” shoqëri aksionare, Beograd, është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, i regjistruar për telekomunikime me kablo dhe veçanërisht për shërbimet e telefonisë fikse dhe mobile, internetit dhe shërbimeve multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

“Telekom Serbia” shoqëri aksionare Beograd ka person të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, edhe atë:

Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, me seli në rrugën “Maksim Gorki” 11/1-3, Shkup, Qendër, e regjistruar për veprimtarinë: telekomunikime nëpërmjet telave, përkatësisht për ofrimin e këtyre shërbimeve: rrjet publik radio-komunikues, qasje e gjerë në internet, shërbime ndër-operatorësh, shërbime telefonike publike në rrjetin publik të komunikimeve mobile, ri-transmetim të programeve televizive, satelit.

Shoqëri e lidhur me MTEL SHPKNJP Shkup është Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup. MTELMOBILE SHPKNJP Shkup vepron në tregun për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile (shërbimi pripejd) dhe nuk ofron abonentëve të saj finalë shërbime mobile postpaid. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup është operator virtual i rrjeteve mobile (OVRM) në tregun maqedonas të komunikimeve elektronike dhe ofron shërbime kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming, shërbime të thirrjeve, SMS-ve dhe internetit.

Gjithashtu, shoqëri e lidhur me “Telekom Serbia” shoqëri aksionare Beograd në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, me seli në Bulevardin “Partizanski Odredi” nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Qendër, e regjistruar për veprimtarinë: telekomunikime satelitore.

KDS-NET SHPK Vršac është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, në momentin e parashtrimit së Njoftimit, i regjistruar për ofrimin e qasjes në internet dhe shërbimeve të internetit, si dhe shpërndarje të përmbajtjes mediatike.

KDS-NET SHPK Vršac nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Sipas parashtruesit të njoftimit, për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, tregjet relevante janë: tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të qasjes fikse brez gjere në internet, tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike, tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të qasjes fikse brez gjerë në internet, dhe tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime lidhur me këtë përqendrim tek Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr.54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë tek Komisioni brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

22.09.2025

Shkup